



Thirrje për regjistrim për



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Modul Trajnimi

Kamp Inovativ mbi Sipërmarrjen

Vendndodhja: Mjediset e Universitetit “Eqrem Çabej”

Datat: 16, 17 & 18 Maj 2023, ora 09:00

Grupi i synuar: Studentët e Universitetit “Eqrem Çabej”

Informacion i Përgjithshëm

Qëllimi i këtij moduli është të ndihmojë studentët nga disiplina të ndryshme që të fitojnë njohuritë bazë në sipërmarrje dhe ta përcjellin këtë njohuri nga ligjëratat në praktikë. Lënda do t'i ndihmojë studentët të fitojnë besim në vetë-analizën e gatishmërisë për sipërmarrje, rolin e sipërmarrësit në zhvillimin ekonomik, strukturën organizative, burimet e financimit, buxhetimin. Studentët do të mësojnë më tej të zhvillojnë projektin e tyre sipërmarrës në ekipe. Kursi do të mbulojë tre aspekte kyçe të sipërmarrjes: 1) si të filloni një projekt sipërmarrës dhe si të gjeneroni ide biznesi, 2) si të zhvilloni ide biznesi përmes mjeteve të përshtatshme të zhvillimit të biznesit 3) si të sillni idetë e biznesit në treg dhe si të shisni ato.


Përshkrimi i trajnimit

Ky kamp Inovacioni organizohet nga Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë në kuadër të projektit EntrAL. Kampi i inovacionit u krijua për studentët e universitetit. Ai synon të promovojë sipërmarrjen dhe inovacionin midis studentëve të ndryshëm. Ky kamp inovacioni bazohet në aftësitë dhe përvojën e transferueshme të fituar gjatë Kampit të Inovacionit të organizuar në kuadër të projektit EntrAL në Universitetin e Turkut në nëntor 2021.

Pjesëmarrësit do të përjetojnë konceptin e Kampit të Inovacionit. Studentët do të zhvillojnë ide biznesi në ekipe dhe do të marrin përvojë praktike në lidhje me sipërmarrjen, procesin e zhvillimit të një ideje biznesi dhe si ta shesin atë. Pjesëmarrësit pritet të angazhohen dhe të sfidojnë veten, ashtu siç do të reagojnë sipërmarrësit e vërtetë në kontekste të ngjashme dhe veçanërisht në kontekstin shqiptar.

Pas kampit, pjesëmarrësit pritet t'i kuptojnë më mirë kërkesat për t'u bërë sipërmarrës dhe ata mund të reflektojnë nëse sipërmarrja mund të jetë një rrugë e mundshme e karrierës në të ardhmen. Kampi prezanton gjithashtu një qasje tjetër se si të mësohet për sipërmarrjen dhe të nxisë aftësitë sipërmarrëse. Studentët e ndryshëm do të pajisen më mirë me aftësi sipërmarrëse dhe të hapur ndaj mentalitetit sipërmarrës,

Kampi organizohet për 3 ditë në mjediset e Universitetit “Eqrem Çabej”. Studentët do të fitojnë 2 ECTS dhe një certifikatë pas përfundimit të kampit të inovacionit.



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Objektivat specifike të trajnimit(Rezultatet e të nxënit)

- Zhvillimi i aftësive për zgjidhjen e problemeve dhe të të menduarit krijues dhe aftësitë e ndërtimit të ekipit.
- Zbatimi i aftësive dhe njohurive për të identifikuar problemet dhe sfidat e biznesit dhe për të gjetur zgjidhje kreative dhe të realizueshme.
- Kuptimi i mundësive sipërmarrëse, aftësitë sipërmarrëse, logjika e biznesit, start up-et dhe mundësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit të dyanshëm me mjedisin e biznesit.
- Promovimi i sipërmarrjes si një rrugë karriere për studentët universitar bachelor dhe master si dhe ofrimi i mundësisë për të zhvilluar karrierën e tyre si konsulentë biznesi në sipërmarrje.



Programi i trajnimit:



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



15 Maj Ditë informuese

Dita 1 - 16 Maj:

- 9:00– 9:15 Fjalë përshëndetëse
- 9:15 – 9:45Thyerja e akullit: Prezantim
- 9:45 – 11:00 Leksion mbështetës Aktiviteti 1: Eksplorimi i sipërmarrjes
- 11:00 – 12:00 Punë e pavarur individuale – Eksplorimi i modeleve të roleve sipërmarrëse
- 12:00 – 13:00 Pushimi i drekës
- 13:00 – 14:00 Folëse e ftuar: Mjedisi i Grave Sipërmarrëse në Shqipëri-Blerta Kallanxhi
- 14:00 – 17:00 Punë e lehtësuar në ekip Aktiviteti 2: Ndërtimi i ekipit
- 17:00-18:30 Leksion mbështetës Aktiviteti 3: Gjenerimi i një ideje biznesi
- 18:30-21:00 Sesion i lehtësuar i punës ekipore Aktiviteti 3: Stuhi mendimesh në ekipe

Dita 2 -17 Maj:


- 9:00 – 10:00 Leksion mbështetës Aktiviteti 4: Mjetet dhe metodat e zhvillimit të biznesit
- 10:00-12:00 Sesion i lehtësuar i punës ekipore Aktiviteti 4: Analiza e mjedisit të biznesit Start Ups
- 12:00-13:00 Pushimi i drekës
- 13:00-14:00 : Leksion mbështetës Aktiviteti 5: Mjetet dhe metodat e zhvillimit të biznesit
- Ora 14:00-15:00 Folës i ftuar : Enea Shalari
- 15:00: 17:00 Sesion i lehtësuar i punës ekipore Aktiviteti 5: Identifikimi i komponentëve kyç të një plani biznesi
- 17:00-18:00 Leksion mbështetës Aktiviteti 6: Modeli i kanavacës së biznesit
- 18:00-19:00 Eksplorimi i Platformës Strategjike
- 19:00-21:00 Sesion i lehtësuar i punës ekipore Aktiviteti 6: Identifikimi i komponentëve kyç të planit të zhvillimit të biznesit në ekipe

Dita 3- 18 Maj:

- 9:00- 12:00 Prezantime dhe diskutime
- 12:00-13:00 Pushimi i drekës
- 13:00-14:00 Mësimet e nxjerra nga modulidhe feedback mbi trajnimin në tërësi.
- 14:00-15:00 Ceremonia e ndarjes së certifikatave për pjesëmarrësit.



- **Regjistrimi i pjesëmarrësve kryhet online, në linkun:**
<https://forms.office.com/r/C9wk0JrCRf>



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



- **Të gjithë pjesëmarrësit do të pajisen me Certifikatë Pjesëmarrjeje, 2 ETCS.**
- **Trajnimi është pa pagesë.**

Për më shumë informacion, lutemi të paraqiteni pranë Qendrës të të mësuarit gjatë gjithë jetës (Qendra LLL).